



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:247956

Datë: 21.01.2025

Numri i dokumentit: 06734113

KPPP.nr. 1385/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komuna e Pejës, që sipas autorizimit përfaqësohet nga Drita Sopi-Gashi, avokate nga Peja, kundër debitorit N.P.SH. "A.C" B.I. me nr. të biznesit ... dhe me seli në Pejë, ..., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 104/24 të datës 08.05.2024, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Zija Bala me zyre në Pejë, jashtë seancës, me datë 21.01.2025 merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit N.P.SH. "A.C" B.I., ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 104/24 i datës 08.05.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Zija Bala, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komuna e Pejës, me datë 08.05.2024 ka lëshuar urdhrin P.nr. 104/24, duke lejuar përmbartimin në bazë të titullit ekzekutiv: Aktgjykim C.nr. 260/16 i datës 31.05.2021 i lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë, i vërtetuar me aktgjykimin AC.nr. 4161/2019 të datës 12.10.2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, - ashtu që është detyruar debitori N.P.SH. "A.C" B.I., që në emër detyrimit të përcaktuar sipas titullit ekzekutiv të lartcekur, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 8,265.00 EUR, me kamatë ligjore 8% nga data 30.03.2016 e deri në pagesën definitive, shpenzimet e procedurës kontestimore prej 1,049.00 EUR si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori ka paraqitur prapësim brenda afatit ligjor përmes të së cilit ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbartimit me arsyetimin se kreditori nuk mund ta kërkoj borxhin sipas

dokumentit për faktin se kanë kaluar mbi tre (3) vite, dhe se ky borxh nuk është kërkuar deri më datë 08.05.2024, andaj edhe është i parashkruar. Gjykatës i ka kërkuar që prapësimi i debitorit të pranohet, të anulohet Urdhri Përmbartimor P.nr. 104/24 i datës 08.05.2024 dhe të obligohet kreditori në pagesën e shpenzimeve të procedurës.

Kreditori, në përgjigje ndaj prapësimi ka kundërshtuar pretendimet e debitorit duke theksuar se kërkesat e gjykuara me vendim të plotfuqishëm kanë efekt juridik dhjetë (10) vite, andaj nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor, përkatësisht Aktgjykimin C.nr. 260/16 të datës 31.05.2021, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë, në bazë të së cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla dhe po ashtu i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata tutje konstatoi se Aktgjykimi C.nr. 260/16 i datës 31.05.2021i plotëson kushtet e përcaktuara edhe në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmëris për përmbartueshmëri”*, ngase i njëjti është i pajisur me klauzolën e përmbartueshmërisë, nga e cila rezulton se vendimi është bërë i formës së prerë me datë 12.01.2021 dhe i ekzekutueshëm me datë 03.03.2021.

Gjykata i gjeti si të pabazuara pretendimet e debitorit se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, kjo meqenëse propozimi për përmbarim është paraqitur më shumë se tre (3) vite nga arritja e kërkesës kjo për faktin se në rastin konkret, kemi të bëjë me një kërkesë të vërtetuar nga gjykata, andaj në rastin konkret, vie në shprehje afati dhjetë (10) vjeçar i parashkrimit i përcaktuar në mbështetje të nenit 361 të Ligjit nr. 04/L-77 për Marrëdhëniet e Detyrimeve me të cilin përcaktohet se *“Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim”*.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1385/24 datë 21.01.2025

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.